

## Raport Mujor për fondin Master Pension

Fondi i Pensionit Privat Master Pension synon optimizimin e kthimit nga investimi duke minimizuar riskun, me qëllimin për t'ju siguruar anëtarëve të Fondit të ardhura më të larta dhe të sigurta në moshën e pensionit.

Data e raportit: 31.03.2026

### Informacion për Fondin

Shoqëria Administruese e Fondit:	Credins Invest
Data e lançimit të fondit:	01 Gusht 2025
Monedha e Fondit:	Lek

Fondi i adresohet investitorëve që kërkojnë një cilësi jete gjatë pensionit e cila nuk rezulton më e ulët sesa faza përpara daljes në pension.

### Profili i rrezikut dhe përfitimit

Ecuria e normës së kthimit të Fondit varet nga lëvizja e normave të interesit të bonove dhe obligacioneve të Republikës së Shqipërisë. Historikisht këto norma kanë rreguar luhatshmëri të ulët.

Rrezik i ulët	Rrezik i lartë					
Përfitimet tipike më të ulëta	Përfitimet tipike më të larta					
1	2	3	4	5	6	7

Fondi Master Pension ka një profil rreziku në nivelin 2, e cila përfaqëson risk të ulët.

### Të dhëna kryesore për Fondin

Vlera Neto e Aseteve	16,852,339.93
Çmimi i kuotës	1,023.0858
Numri i anëtarëve	150
Kthimi nga investimi (01.08.2025-31.03.2026)*	2.31%

\* Të gjitha kostot dhe tarifat janë zbritur përpara llogaritjes së kthimit nga investimi.

### Karakteristikat e rrezikut të asetëve në Fond

#### Depozitat Bankare

Depozita Bankare si klasë asetë përmban rrezikun e kredisë së bankës dhe rrezikun e rikthimit në momentin e maturimit të saj.

Rreziku i rikthimit nënkupton uljen e normës së interesit kur depozita rivendoset me të njëjtin maturitet.

#### Obligacionet dhe Bonot Qeveritare

Këto asetë janë të emetuara nga Qeveria, agjencitë apo ndërmarrje të sponsorizuara nga Qeveria. Megjithatë, qeveritë nuk garantojnë pagesën e interesit apo principalit. Obligacionet apo Bonot qeveritare janë subjekt i rrezikut nga normat e interesit dhe kanë nota krediti ("rating") të ndryshme. Bonot përmbajnë rrezik nga interesat më të lartë se obligacionet me të njëjtën kohë deri në maturim.

Në 24 mars 2026, Agjencia Ndërkombëtare "Standard & Poor's" ri-konfirmoi vlerësimin për Shqipërinë në kategorinë 'BB' me perspektivë "të qëndrueshme". Gjithashtu, Agjencia Ndërkombëtare e vlerësimit "Moody's" ri-konfirmoi vlerësimin e saj në datën 14 mars 2026, duke vlerësuar perspektivën e Shqipërisë në kategorinë "Ba3 – e qëndrueshme". Rritja e vlerësimit të kreditit për Shqipërinë, redukton rrezikun e kreditit të asetëve të Fondit, duke qenë se asetet e Fondit investohen në instrumentet financiare që emetohet nga shteti shqiptar.


### Kostot dhe Tarifat

Komisioni i Administrimit të Fondit mbahet nga asetet e Fondit, si më poshtë:

Pagesa e hyrjes	0%
Pagesa e daljes	0%
Komisioni vjetor i administrimit	Deri në 1.2% në vit e Vlerës Neto të Aktiveve
Tarifa të tjera të vazhdueshme	Sipas Prospektit, Seksioni 18
<i>Komisioni i administrimit dhe të gjitha kostot e tjera të listuara në një vit kontabël nuk do të tejkalojnë në asnjë rast maksimumin prej 1.5% të vlerës neto të aktiveve të fondit.</i>	
Penalitetet në rast tërheqje të parakohëshme	Sipas Prospektit, Seksioni 11

### Shpërndarja e Instrumenteve si përqindje e Aseteve Totale


Shpërndarja e Instrumentave	ALL	%Aseteve
Obligacione	15,865,168.01	86.20%
Mjete monetare dhe ekuivalente të tyre	1,056,113.23	13.80%





Rruga “Nikolla Tupe”, Nr. 1, Kati 3  
Tiranë, Shqipëri  
NIPT: K52311009R  
+355 69 60 60 058  
[www.credinsinvest.com](http://www.credinsinvest.com)

Me Vendimin nr. 93 datë 30.06.2025, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare miratoi fondin e ri të pensionit privat me pjesëmarrje të hapur “Master Pension Fund”. Ky Fond i jep mundësi çdo individit ose punëdhënësi, i cili ka për objektin rritjen e përgjegjësisë sociale, duke kontribuar për pensionet e punonjësve të tij, të investojnë në një fond afatgjatë në monedhën LEK me një profil rreziku të ulët (niveli 2). Individët që kanë objektin të gëzojnë një të ardhur të kënaqshme shtesë në moshën e pensionit, kanë mundësi të kursejnë vlera të menjëhershme për të rikuperuar kohën e humbur, si edhe vlera periodike më të larta duke përfutur maksimalisht nga benefiti fiskal që ka ky produkt.



*Performanca e kaluar është vetëm për qëllime ilustruese dhe nuk është një udhëzues, premtim apo garanci për performancën e ardhshme. Për informacion shtesë, jeni të ftuar të lexoni Prospektin e Fondit si dhe të vizitoni faqen zyrtare të shoqërisë [www.credinsinvest.com](http://www.credinsinvest.com)*